REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PUSTEC

SEKTORI I NDIHMES EKONOMIKE DHE SHERBIMI SOCIAL

Nr.101/ 1 Prot

Pustec më 21.01.2026

PROJEKT-VENDIM

Nr.2 Datë 21.01.2026

MIRATIMI I KRITEREVE PËR FAMILJET QË TRAJTOHEN SIPAS FONDIT TË KUSHTËZUAR PËR BLLOK NDIHMËN DERI 6% PËR VITIN 2026

Duke u mbështetur në nenin 8, pika 2, neni 9, pika 1.1.1, shkronja "a" dhe "b" , neni 24, pika 1, neni 55, pika 2 dhe 6, ligji nr.139, datë 17.12.2015, "Për vetë qeverisjen vendore" i ndryshuar, ligjit 57/2019 "Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë",vendimit nr.597, datë 22.07.2020, të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kritereve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të Ndihmës Ekonomike" të ndryshuar, pikës 4 të udhëzimit nr.5, dt 17.02.2017 të Ministrisë të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale "Për përfitimin dhe përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike deri 6 %", dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.664 datë 24.10.2025, Për propozimin e projektligjit "Për buxhetin e vitit 2026" Sektori i ndihmës ekonomike dhe sherbimi social të Bashkisë Pustec, i propozojnë Këshillit të Bashkisë.

TË MIRATOJ

1. Ky projekt-vendim ka për objekt miratimin e kritereve, procedurës së përzgjedhjes dhe mënyrës së trajtimit të familjeve në nevojë që përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok–ndihmën ekonomike deri në masën 6%, jashtë sistemit të pikëzimit.
2. Nga fondi i përcaktuar në nenin 1 përfitojnë familjet që plotësojnë një ose më shumë nga kriteret e mëposhtme:

a) Familjet të cilët nuk e kanë njërin nga bashkeshortët dhe kanë fëmijë nën moshë pune
b) Familjet të cilat nga arsye të ndryshme kanë humbur njërin nga bashkeshortët dhe nuk kanë mundësi jetese.
c) Familjet të cilat kanë antarë në moshë pune por e kanë humbur përkohësisht aftësinë për punë (të operuar ose sëmure nga sëmundje të ndryshme).
d) Familjet në nevojë që kanë aplikuar dhe nuk janë shpallur përfitues nga sistemi i pikëzimit.
e) Familjet të cilat nuk kanë mundësi financiare për të përballuar shpenzimet e nxenësve dhe studentëve.
f) Familjet me probleme shëndetësore të dukshme ku familjarët e tyre nuk trajtohen me KEMP nga komisioni mjeko-ligjor.
g) Familjet e divorcuara,pa të ardhura dhe me ardhura të pamjaftueshme.
h) Familjet me fëmijë jetim.
i) Familjet me të moshuar të sëmur me të ardhura të pakta.

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet **Sektori i Shërbimit Social dhe Strehimit**, pranë Bashkisë Pustec.

Marjeta Serbin Specialist i NE dhe Strehimit_____

Para Trajko Specialist PAK, drejtat e femijeve, dhuna ne familje dhe barazi gjinore.

KRYETARI I BASHKISË
PALI KOLEFSKI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA PUSTEC

Adresa : Pustec, Korçë Tel. 0035586792012 e-mail : bashkia.pustec@gmail.com